



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Adresa:Fushe-Arrez,Prefektura Shkoder,Tel:027123131,Email:info@bashkiafushearrez.gov.al

Fushe-Arrez me, 08 /04/2024

Procesverbal -Tipi i kontrates - Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashk dokumentat e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS - “Rivnie ne funksion te sistemit te rrugeve auto-rurale te demtuara, si pasoje e shirave te shumte te date 18.01.2024 ne territorin e Bashkise Fushe-Arrez”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45112400-9 Punime germuese

VLERA E FONDIT LIMIT – 1 999 907 (nje milion e nenteqind e nentedhete e nente mije e nenteqind e shtate) Leke **pa TVSH.**

Në bazë të nenit 77, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 41, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Fushë-Arrez**, ka hartuar procesverbalin për argumenimin dhe miratimin e specifikimeve tenike dhe kriterëve për kualifikimin për procedurën e sipercituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a) **Kopjet e çertifikuara të bilanceve për vitin 2023** të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse e të konfirmuara nga ky autoritet.
- b) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitetet për vitin **2023**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin nr. 160/2020 "Per prokurimin publik" neni 77, pika 3, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 43 pika 4., sipas shtojces 7 pika 1 germa dh tek DST.

Përcaktimi i vitit të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilnaceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë.

2.2.2 Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë jo më e madhe se 20% të vlerës së për llogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik per permbushjen me sukses te kontrates, ku shënohen vlerat, afati i perfundimit te kontrates ose fature tatimore te shitjes, ku shenohen data, shumat dhe sherbimet e realizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 germa b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

NP-1 A

NP-4 A

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.neni 41 pika 4 germa a.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
N.P – 1 A	Punime Germimi	Percaktimet ne preventiv	A
N.P - 4 A	(Punime ne rruge pavaresisht karakterit qe jane)	Percaktimet ne preventiv	A

2.3.2 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :

- Eskavator me goma/zinxhir cop 2
- Fadrome cop 2

- Mjet transporti veteshkarkues 5 ton e lart cop 1,
- Mjet transporti veteshkarkues 15 ton e lart cop 1

Mjetet e lartpërmendura duhet të jenë në pronësi ose me qera dhe ofertuesi duhet të paraqesë deklarinimin për disponimin e makinerive (sipas shtojcës 9) .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 41 pika 4 germa ç.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar e të pajisur deshmi perkatese:

- Drejtues mjetesh 2(dy)
- Manovrator 2(dy)
- Puntore te thjeshte 6 (gjashte)

Punonjësit e mësipërm duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjim nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 77, pika 4, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 41 pika 4 germa b. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për të përmbushur me sukses kontratën.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.